



QENDRA PËR
KËSHILLIM NË
KARRIERË
PRISHTINË



KATALOG I PROFILEVE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS



British Embassy
Pristina

PARTNERËT: Ky publikim është mundësuar nga Ambasada britanike në Prishtinë, në kuadër të projektit "Themelimi i Qendrës për Këshillim në Karrierë", i cili ka për qëllim që t'i ndihmojë të rinjtë e shkollave profesionale të komunës së Prishtinës, për t'i arritur aspiratat dhe për të qenë sa më të suksesshëm në karrierë.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. PREZANTIM I SHKURTËR I PROFILEVE	7
3. TË OFRUARA NGA SHKOLLAT PROFESIONALE	7
4. SHKOLLA E AGROBIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË - “ABDYL FRASHËRI”	11
5. SHKOLLA EKONOMIKE DHE JURIDIKE - “HOXHË KADRI PRISHTINA”	17
6. SHKOLLA PËR TREGTI, HOTELERI DHE TURIZËM - “7 SHTATORI”	25
7. SHKOLLA E MAKINERISË DHE TEKSTILIT - “SHTJEFËN GJEÇOVI”	31
8. SHKOLLA E MJEKËSISË - “DR. ALI SOKOLI”	39
9. SHKOLLA E MUZIKËS - “PRENK JAKOVA”	45
10. SHKOLLA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE - “GJIN GAZULLI”	49
11. SHKOLLA TEKNIKE - “ABDYL FRASHËRI”	57

Hyrje

Qendra për Këshillim në Karrierë, e cila vepron në kuadër të Komunës së Prishtinës, ka për qëllim t'i ndihmojë kompanitë që, në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë, të gjejnë praktikantë dhe punëtorë të kualifikuar, të cilët do të jenë të përshtatshëm për t'i përmbushur kërkesat e tyre. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me shkollat profesionale dhe posedimit të data-bazave me kontakte të kandidatëve dhe bizneseve, Qendra do të shërbejë si një urë lidhëse midis shkollave profesionale dhe bizneseve, të cilat janë të interesuara për plasimin dhe tërheqjen e kuadrove cilësore të profesioneve të ndryshme. Qëllimi i këtij katalogu është që t'i informojë kompanitë publike dhe ato private, mbi profesionet ekzistuese dhe potencialin që ofrojnë shkollat profesionale. Kuadrot që dalin nga shkollat profesionale mund të jenë ndihmesë për kompanitë, duke iu mundësuar atyre që të arrijnë më shpejt dhe më lehtë deri tek gjetja e stafit të kualifikuar, ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme, si dhe rritja e konkurrencës në treg. Ky katalog u dedikohet kompanive private dhe publike, të cilat kanë potencial për të ofruar punë praktike (internship), apo vende të reja të punës për kuadrot që dalin nga shkollat profesionale. Përpilimi i këtij katalogu është bërë duke u bazuar në programet mësimore të arsimit profesional, të miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

PREZANTIM I SHKURTËR I PROFILEVE TË OFRUARA NGA SHKOLLAT PROFESIONALE

Vërejtje: Numri i profileve profesionale të ofruara nga shkollat profesionale, mund të ndërrojë nga viti në vit. Kjo do të varet drejtpërdrejt nga vendimi i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës, e cila shpall konkursin konform nevojave të shkollave dhe tregut të punës.

SHKOLLA E AGROBIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË

1. Agrobiznes
2. Fermer
3. Hortikulturë
4. Mbrojtje të bimëve
5. Teknologji ushqimore
6. Veterinari

SHKOLLA EKONOMIKE DHE JURIDIKE

ADMINISTRATË

1. Asistent i administratës
2. Asistent Juridik
3. Organizator i aktiviteteve shoqërore

ADMINISTRIM BIZNESI

4. Administrim i zyrës
5. Financa
6. Marketing Ekonomi
7. Kontabilitet
8. Banka e sigurime
9. Shpedicion dhe logjistikë

SHKOLLA E HOTELERISË, TURIZMIT DHE TREGTISË

1. Asistent i hotelit
2. Asistent i restorantit
3. Gjellëbërës
4. Pastiçeri
5. Asistent i turizmit
6. Shitës me shumicë dhe pakicë

SHKOLLA E MAKINERISË DHE TEKSTILIT

MEKANIKA

1. Automekanik
2. Metalpunues
3. Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit
4. Instalim të ujësjellës dhe kanalizimit
5. Mekanik i makinave
6. Operator i prodhimit
7. Saldator

TEKSTIL

8. Konfeksion Transport dhe Trafik
9. Transport Rrugor

SHKOLLA E MJEKËSISË

1. Infermier i përgjithshëm
2. Infermier i pediatriisë
3. Mami- infermier i obstetrikës
4. Teknik i dhëmbëve
5. Teknik i farmacisë
6. Teknik i fizioterapisë
7. Teknik -laborant

SHKOLLA E MUZIKËS

DREJTIMI I PËRGJITHSHËM

1. Bashkëpunëtor muzikor
Drejtimi Artistik (Instrumental)
2. Interpretues - piano
3. Interpretues - harqe (violinë, violë, violonçel, kontrabas)
4. Interpretues - frymorë
(flautë, klarinet, trombon, bori)
5. Interpretues- solo këngë

SHKOLLA TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

1. Informatikë
2. Elektronikë konsumuese dhe pajisje të zyrave
3. Elektronikë Industriale. Elektroteknikë
4. Instalues Elektrik
5. Energjetikë
6. Komunikime audio dhe video
7. Makina elektrike
8. Mekatronikë
9. Telekomunikacion

SHKOLLA TEKNIKE

1. Arkitekturë
2. Art Figurativ dhe Aplikativ
3. Gjeodezi

GRAFIKË

4. Libërlidhje
5. Grafik i përgatitjes grafike
6. Grafik imedieve
7. Grafik i shtypit
8. Ndërtimtari
9. Postë -Telekomunikacion





SHKOLLA E AGROBIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË “Abdyl Frashëri”

Shkolla profesionale e Agrobiznesit dhe Teknologjisë ofron mësim profesional trevjeçar, në këto profile: Agrobiznes, Hortikulturë, Mbrojtje të bimëve, Teknologji ushqimore dhe Veterinari.

Përparësitë e shkollës

Përparësitë e kësaj shkolle janë se posedon të gjitha kushtet për t'u ofruar nxënësve mësim teorik dhe praktik, duke pasur në dispozicion: firmat ushtrimore, kuzhinën trajnuese, pemishten, fermën dhe serrat. Në vitin e parë mësimi zhvillohet katër ditë në javë mësim teorik dhe një ditë mësim praktik, viti i dytë përmban tri ditë e gjysmë teori dhe një ditë e gjysmë praktikë dhe viti i fundit ka tri ditë mësim teorik dhe dy ditë mësim praktik.

1. AGROBIZNESI

Modulet mësimore teorike

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësit e kësaj shkolle ndjekin modulet teorike profesionale, siç janë: kimi aplikative, biologji aplikative, bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve, bazat e teknikës bujqësore, prodhimtari bimorë, mekanizimi bujqësor, prodhimtari blegtorale, mbrojtje e bimëve, marketing dhe shitje e prodhimeve bujqësore, kontabilitet në agrobiznes, financa në agrobiznes,

organizimi i prodhimtarisë bujqësore, menaxhimi i fermës dhe mbrojtje e ambientit jetësor.

Modulet mësimore praktike

Sa i përket moduleve të praktikës profesionale, ato janë si në vijim: siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit, marrja e mostrave të tokës, ruajtja dhe përdorimi i plehrave, prodhimi i fidanëve, kultivimi i perimeve në ambiente të hapura, përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve agroteknike, mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve agroteknike, kultivimi i kulturave lavërtare, kultivimi i perimeve në serra, ngritja dhe mirëmbajtja e kopshteve me bimë dekorative, kultivimi i pemëve frutore, shtimi dhe përkujdesja ndaj kafshëve shtëpiake, grumbullimi dhe ruajtja e prodhimeve bujqësore, marketingu dhe shitja e prodhimeve bujqësore, organizimi i aktiviteteve në ndërmarrjet bujqësore, hartimi i ofertës dhe kërkesës, evidentimi i blerjeve dhe shitjeve, menaxhimi i projekteve, përmirësim i aktiviteteve të agrobiznesit, përpilimi i bilancit fillestar dhe mbrojtja e mjedisit.

2. FERMER

Lëndët profesionale

Biologji, kimi, bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e

bimëve, teknika bujqësore, prodhimtaria bimore, prodhimtaria blegtorale, mbrojtja e bimëve, përpunimi dhe ruajtja e prodhimeve bujqësore - blegtorale, kultivimi i perimeve në serra dhe ekonomia dhe organizimi.

Modulet e praktikës profesionale

Mirëmbajtje ferme 1, përdorim traktori 1, ujitja dhe kullimi, përdorimi i plehrave, përgatitja e tokës për mbjellje, kujdesi gjatë rritjes së bimëve, mirëmbajtje ferme 2, përdorim traktori 2, mirëmbajtje e mekanizmave të bujqësisë, përdorimi i makinave mbjellëse, prodhimi i drithërave, prodhimi i perimeve, rritja e bimëve në serra, shtimi i pemëve frutore, kultivimi i pemëve frutore, të ushqyerit e kafshëve, higjiena dhe shëndeti i kafshëve, shtimi i kafshëve, mbrojtja e bimëve, mirëmbajtje traktori dhe grumbullimi dhe ruajtja e prodhimeve bujqësore.

3. HORTIKULTURË

Lëndët profesionale

Biologji, kimi, bazat mbi tokën dhe të ushqyerit e bimëve, teknikë bujqësore, botanikë, prodhimi i fidanëve, mbrojtja e bimëve, kultivimi i luleve njëvjeçare dhe qepore, kultivimi i luleve shumëvjeçare,

lulet e saksive, rregullimi i kopshteve, dekorimi i ambienteve të brendshme, dendrologji.

Modulet e praktikës profesionale

Teknika bujqësore, bazat e tokës dhe të ushqyerit e bimëve, prodhimi i fidanëve, kultivimi i luleve shumëvjeçare, kultivimi i luleve njëvjeçare, qepore dhe luleve në saksitë, përcaktimi i drurëve zbukurues, rregullimi i kopshteve, zbukurimi i ambienteve të brendshme.

4. MBROJTJA E BIMËVE

Lëndët profesionale

Biologji, kimi, bazat e shkencës së tokës dhe të ushqyerit e bimëve, teknikë bujqësore, botanikë, meteorologji, fitopatologji, mikrobiologji, makina dhe aparate, bazat e prodhimtarisë bimore, entomologji, organizimi i prodhimtarisë bimore, prodhimtari organikë, barërat e këqija dhe luftimi i tyre.

Modulet e praktikës profesionale

Profili pedologjik dhe hulumtimi i tokës në terren, marrja e mostrave në terren, ruajtja e plehrave mineral dhe të stallës, përdorimi i plehrave në të ushqyerit e bimëve, përdorimi i traktorit dhe

pajisjeve shtesë, mirëmbajtja dhe konservimi i traktorit, përdorimi dhe mirëmbajtja e mekanizimit bujqësorë, konstatimi i shkallës së infektimit të bimëve nga sëmundjet në terren; zgjedhja e llojit të preparatit për mbrojtjen e bimëve nga infektimet dhe përdorimi i tyre me makinat spërkatëse-pluhurosëse; pastrimi, mirëmbajtja e makinave spërkatëse - pluhurosëse dhe mbrojtja e mjedisit të punës nga ndotjet e mundshme; përgatitja e tokës për mbjellje, fara dhe mbjellja e saj, masat agroteknike që aplikohen gjatë rritjes së bimëve dhe grumbullimi i prodhimeve lavërtare e perimore; përdorimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e makinave e aparateve; mikrobiologji me higjienë; konstatimi i shkallës së dëmtimit të bimëve nga dëmtuesit, në terren; trajtimi i bimëve me insekticide kundër dëmtuesve; pastrimi, mirëmbajtja e makinave spërkatëse - pluhurosëse pas përdorimit të insekticideve; trajtimi i bimëve me herbicide kundër barërave të këqija.

5. TEKNOLOGJIA USHQIMORE

Teknologjia ushqimore ndahet në disa profile, siç janë: furrtar, përpunues i mishit, përpunimi i frutave dhe përpunimi i qumështit.

Lëndët profesionale

Bazat e kimisë së përgjithshme dhe inorganike, biologji aplikative, lënda e parë ushqimore, kimi organike, makinat dhe proceset teknike, mikrobiologji dhe higjienë, teknologjia ushqimore, biokimi, kontrolli i cilësisë së prodhimeve ushqimore.

Modulet e praktikës profesionale

Kimi analitike, përfitimi, pranimi, ruajtja dhe transportimi i lëndës së parë me prejardhje bimore dhe shtazore, përpunimi dhe ruajtja e prodhimeve me prejardhje shtazore dhe bimore, metodat e përcaktimit sasior të substancave, mikrobiologji dhe higjienë, matja e vlerës së PH-së në mostrat e tretësirave, përcaktimi i yndyrave të ndryshme me metodën e ekstraktimit, përpunimi dhe ruajtja e prodhimeve me prejardhje bimore dhe shtazore-2, kryerja e proceseve teknike me makina dhe kontrolli i cilësisë dhe siguria e prodhimeve me prejardhje shtazore.

6. VETERINARI

Lëndët profesionale

Biologji, kimi, anatomia e kafshëve, fiziologjia e kafshëve, blegtoria, patologjia e përgjithshme, farmakologji, biokimi, të ushqyerit e kafshëve,

sëmundjet e brendshme të kafshëve shtëpiake, sëmundjet invazive, lindshmëria veterinare, riprodhimi dhe mbarësimi artificial, kontrolli i cilësisë dhe siguria e prodhimeve me prejardhje shtazore.

Modulet e praktikës profesionale

Nomenklatura anatomike, ndërtimi i sistemeve të organeve të brendshme, analizë e gjakut dhe funksionit të zemrës, kontrolli i cilësisë dhe siguria e prodhimeve me prejardhje shtazore, funksionimi i sistemit të tretjes, frymëmarrjes, urogjenitale dhe nervore, proceset degjenerative e nekrotike në inde dhe qeliza, trajtimi i kafshëve me forma të ndryshme farmaceutike veterinare, të ushqyerit e gjedhëve, dhënia e ndihmës së parë kafshëve të sëmurë, dezinfektimi i objekteve, pajisjeve dhe mjeteve transportuese, trajtimi i kafshëve kundër parazitëve, përcaktimi dhe trajtimi i patologjive të gjirit të kafshëve shtëpiake, ekzaminimi dhe trajtimi i kafshëve ripërthypëse në rastet e fryrjes së plëndësit me gaze, inseminimi artificial dhe kontrolli i cilësisë dhe siguria e prodhimeve me prejardhje shtazore.





SHKOLLA EKONOMIKE DHE JURIDIKE “Hoxhë Kadri Prishtina”

Shkolla profesionale ekonomike dhe juridike, ka profile të ndryshme në kuadër të dy drejtimeve të saj. Në drejtimin ekonomik ekzistojnë tri profile: Banka dhe sigurime, Shpeditcion dhe logjistikë dhe Kontabilitet. Ndërkaq, në degën e Juridikut janë këto profile: Asistent juridik, Asistent i administratës, Organizator i aktiviteteve shoqërore, si dhe Administrim i zyrës.

Përparësitë e shkollës

Përparësia e kësaj shkolle është posedimi i firmave ushtrimore, ku nxënësit kanë mundësi që edhe modulet e praktikës profesionale t'i kryejnë brenda shkollës.

1. ADMINISTRATË, PROFILI: ASISTENT JURIDIK

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: veprimtari administrative, bazat e së drejtës, shkrim ligjor, bazat e së drejtës së punës, korrespondencë dhe komunikim me palë, e drejta e sigurimit social, bazat e evidencës amë, bazat e së drejtës administrative, punët e qarkullimit juridik, kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve, bazat e procedurës admi-

nistrative, bazat e së drejtës penale dhe bazat e së drejtës familjare dhe trashëgimore.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë: klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, sistemi i klasifikimit, shkrimi i shkresave të thjeshta, komunikimi me mjetet komunikuese, rendi i firmës-rregullorja, procedurat e themelimit të marrëdhënies së punës, puna në sekretari, shkrimi i shkresave zyrtare, organizimi i udhëtimeve zyrtare, prezantimi i firmës ushtrimore, masat disiplinore – procedurat e shqiptimit, përpilimi dhe paraqitja e dokumenteve të punës nga materiali i diktuar, aftësitë praktike të folurit, lidhja e kontratave të ndryshme, ruajtja dhe gjetja e informacionit, duke përdorur një sistem arkivimi të dhënë, përpilimi i dokumenteve juridike të posaçme, zgjidhja e kontesteve administrative në mes të firmave ushtrimore, korrespondenca në lidhje me shit-blerjen dhe qasja praktike në institucionet reale.

2. ADMINISTRATË, PROFILI: ASISTENT I ADMINISTRATËS

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson

modulet teorike profesionale, siç janë: veprimtari administrative, bazat e së drejtës, shkrim ligjor, bazat e së drejtës së punës, korrespondencë dhe komunikim me palë, e drejta e sigurimit social, bazat e evidencës amë, bazat e së drejtës administrative, punët e qarkullimit juridik, kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve, bazat e procedurës administrative, arkivistikë dhe veprimtari bibliotekare.

Modulet e praktikës profesionale

Sa i përket moduleve të praktikës profesionale, ato janë: veprimtari administrative, bazat e së drejtës, shkrim ligjor, bazat e së drejtës së punës, korrespondencë dhe komunikim me palë, e drejta e sigurimit social, bazat e evidencës amë, bazat e së drejtës administrative, punët e qarkullimit juridik, kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve, bazat e procedurës administrative, arkivistikë dhe veprimtari bibliotekare.

3. ADMINISTRATË, PROFILI: ORGANIZATOR I AKTIVITETEVE SHOQËRORE

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: veprimtari administrative, bazat e së drejtës, shkrim ligjor,

bazat e së drejtës së punës, korrespondencë dhe komunikim me palë, e drejta e sigurimit social, bazat e evidencës amë, bazat e së drejtës administrative, punët e qarkullimit juridik, kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve, bazat e procedurës administrative, bazat e retorikës, e drejta e autorit dhe mjetet teknike për incizim, zërim dhe ndriçim.

Modulet e praktikës profesionale

Sa i përket moduleve të praktikës profesionale, janë si në vijim: klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, sistemi i klasifikimit, shkrimi i shkresave të thjeshta, komunikimi me mjetet komunikuese, rendi i firmës-rregullorja, procedurat e themelimit të marrëdhënies së punës, puna në sekretari, shkrimi i shkresave zyrtare, organizimi i udhëtimit-zyrtare, prezantimi i firmës ushtrimore, masat disiplinore –procedurat e shqiptimit, aftësitë praktike të të folurit, lidhja e kontratave të ndryshme, të folurit në publik, organizimi i aktiviteteve shoqërore, zgjidhja e kontesteve në mes firmave ushtrimore, korrespondenca në lidhje me shitjen dhe qasja praktike në institucionet reale.

4. ADMINISTRIM BIZNESI, PROFILI: ADMINISTRIM I ZYRËS

Lëndët profesionale

Kontabilitet, financë, vendi i tregut, komunikim biznesi, e drejta, struktura dhe zhvillimi i ndërmarrjes, marketing, format e pronësisë në afarizëm, shpenzime afariste, biznesi dhe ligjet në BE, tregtia ndërkombëtare, sigurimi dhe sistemi bankar në Kosovë, sistemi financiar dhe revizioni, kontabiliteti i drejtimit.

Modulet e praktikës profesionale - Firma ushtrimore

Përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, kontrata dhe korrespondenca në biznes, komunikimi me mjete komunikuese, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, menaxhimi i biznesit të vogël, veprimet me arkën, zhvlerësimi i mjeteve joqarkulluese, pasqyra 3-mujore e tatimeve dhe kontributeve të bizneseve të vogla individuale, deklarimi i TVSH-së, pasqyra e kontributeve për pensione, aspekte financiare të industrisë, hartimi i ofertës dhe kërkesës, përgatitja e një reklame të thjeshtë, qarkullimi i pagesave, mundësi personale të financimit, zhvillimi personal

dhe profesional, ndërmarrësia, menaxhimi i kualitetit, aranzhimet punuese, menaxhimi i informatës.

5. ADMINISTRIM BIZNESI, PROFILI: FINANCA

Lëndët profesionale

Kontabilitet, financë, vendi i tregut, komunikim biznesi, e drejta, struktura dhe zhvillimi i ndërmarrjes, marketing, format e pronësisë në afarizëm, shpenzime afariste, biznesi dhe ligjet në BE, tregtia ndërkombëtare, sigurimi dhe sistemi bankar në Kosovë, sistemi financiar dhe revizioni, kontabiliteti i drejtimit.

Modulet e praktikës profesionale - Firma ushtrimore

Përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, kontrata dhe korrespondenca në biznes, komunikimi me mjete komunikuese, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, menaxhimi i biznesit të vogël, veprimet me arkë, zhvlerësimi i mjeteve jo-qarkulluese, pasqyra 3-mujore e tatimeve dhe kontributeve të bizneseve të vogla individuale, deklarimi i TVSH-së, pasqyra e kontributeve për pensione, aspekte financiare të industrisë, hartimi i ofertës dhe kërkesës, përgatitja e një reklame të thjeshtë, qarkullimi i pagesave, mundësi personale

të financimit, zhvillimi personal dhe profesional, ndërmarrësia, menaxhimi efikas i blerjes, menaxhimi financiar dhe raporti financiar.

6. ADMINISTRIM BIZNESI, PROFILI: MARKETING

Lëndët profesionale

Kontabilitet, financë, komunikim biznesi, e drejta, vendi i tregut, struktura dhe zhvillimi i ndërmarrjes, marketing, format e pronësisë në afarizëm, shpenzime afariste, biznesi dhe ligjet në BE, tregtia ndërkombëtare, sistemi dhe sigurimi bankar në Kosovë, marketing i avancuar dhe planifikimi i shitjes.

Modulet e praktikës profesionale - Firma ushtrimore

Përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, kontrata dhe korrespondenca në biznes, komunikimi me mjete komunikuese, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, menaxhimi i biznesit të vogël, veprimet me arkën, zhvlerësimi i mjeteve jo-qarkulluese, pasqyra 3-mujore e tati- mit dhe kontributeve të bizneseve të vogla individuale, deklarimi i TVSH-së, pasqyrat e kontributeve për pension, aspekte financiare të industrisë,

hartimi i ofertës dhe kërkesës, përgatitja e një reklame të thjeshtë, qarkullimi i pagesave, mundësi personale e financimit, zhvillimi personal dhe profesional, ndërmarrësia, inteligjenca e tregut, shitja dhe evidentimi i saj, komunikimi me klientë dhe bashkëpunëtorë, publiciteti dhe promovimi.

7. EKONOMI, PROFILI: BANKA DHE SIGURIME

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: kontabilitet, financë, statistikë, bazat e së drejtës dhe e drejta, njohja e mallit, komunikim biznesi, afarizëm bankar, bazat e sigurimeve, marketing dhe afarizëm komercial.

Modulet e praktikës profesionale

Sa i përket moduleve të praktikës profesionale, janë si në vijim: klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, sistemi i klasifikimit, përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, komunikimi me mjetet komunikuese, kontratat dhe korrespondenca në biznes, veprimet me arkën, hartimi i ofertës dhe i kërkesës, blerja dhe evidentimi i saj, shitja dhe evidentimi i saj, zhvlerësimi i mjeteve jo qar-

kulluese, plotësimi i dokumentacionit të biznesit me kompjuter, veprimtaria e përditshme e një biznesi të vogël, marrëdhëniet e biznesit me bankat, qasja në firmat reale, komunikimi me klientët dhe bashkëpunëtorët, praktikat e kërkimit të tregut, përgatitja e një reklame të thjeshtë, aplikimi për sigurimin shëndetësor për udhëtimet jashtë vendit dhe sigurimin nga aksidentet e personave, aplikimi për sigurimin e mjeteve motorike, DUD-i dokumenti unik doganor, mënyrat e kryerjes së pagesave, qarkullimi i pagesave dhe qasja në firmat reale.

8. EKONOMI, PROFILI: KONTABILIST

Lëndët profesionale

Përveç lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale siç janë: kontabilitet, financë, statistikë, bazat e së drejtës dhe e drejta, njohja e mallit, komunikim biznesi, marketing, afarizëm bankar dhe afarizëm komercial.

Modulet e praktikës profesionale

Sa i përket moduleve të praktikës profesionale, janë si në vijim: klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, regjistrimi në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, komunikimi me mjetet komunikuese,

kontrata dhe korrespondenca e biznesit, veprimet me arkën, hartimi i ofertës dhe i kërkesës, blerja dhe evidentimi i saj, shitja dhe evidentimi i saj, zhvlerësimi i mjeteve jo qarkulluese, qarkullimi i pagesave, marrëdhëniet e biznesit me bankat tjera, komunikim me klientë dhe bashkëpunëtorë, qasja në firmat reale, praktikat e kërkimit të tregut, deklarimi i TVSH-së, pasqyra e kontributeve për pension, pasqyra 3-mujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale, dokumenti unik doganor DUD-I, veprimtaria e përditshme e një biznesi të vogël, mënyrat e kryerjes së pagesave dhe qasja në firmat reale.

9. EKONOMI, PROFILI: SHPEDICION DHE LOGJISTIKË

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: kontabilitet, doganë, financë, statistikë, bazat e së drejtës dhe e drejta, njohje malli, komunikim biznesi, menaxhimi i logjistikës, depo afariste, bazat e transportit dhe bartjes dhe marketing.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë si në vijim:

klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, sistemi i klasifikimit, përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, komunikimi me mjetet komunikuese, kontratat dhe korrespondenca në biznes, veprimet me arkën, hartimi i ofertës dhe i kërkesës, blerja dhe evidentimi i saj, shitja dhe evidentimi i saj, zhvlerësimi i mjeteve jo qarkulluese, qarkullimi i pagesave, veprimtaria e përditshme e një biznesi të vogël, marrëdhëniet e biznesit me bankat, qasja në firmat reale, komunikimi me klientët dhe bashkëpunëtorët, dokumenti unik doganor DUD-I, praktikat e kërkimit të tregut, përgatitja e një reklame të thjeshtë, mirëmbajtja e logjistikës në zyra, sigurimi i logjistikës për seminare, Uorkshope, procedurat në transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave, mënyrat e kryerjes së pagesave dhe qasja në firmat reale.





SHKOLLA PËR TREGTI, HOTELERI DHE TURIZËM “7 Shtatori”

Shkolla ka tri degë, në kuadër të të cilave ka profile të ndryshme, si p.sh.: Hoteleria ka profilin e asistentit të hotelit, asistentit të restorantit, gjellëbërësit dhe pastiçerisë; drejtimin e Turizmit, me profilin e asistentit të turizmit dhe Tregtisë, me profilin tregtar me pakicë dhe shumicë.

Përparësitë e shkollës

Përparësi e kësaj shkolle janë marrëveshjet që shkolla ka me disa hotele dhe restorante, ku nxënësit dërgohen për t'i realizuar orët e praktikës. Mësimi në vitin e parë fillon me 4 ditë në javë mësim teorik, ndërsa 1 ditë mësim praktik, viti i dytë fillon me 3.5 ditë në javë mësim teorik, ndërsa 1.5 ditë mësim praktik, dhe viti i fundit ka 3 ditë mësim teorik dhe 2 ditë mësim praktik.

1. HOTELERI, PROFILI: ASISTENT HOTELI

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: bazat e turizmit, njohje e mallit ushqimor, biologji me higjienë, shërbim hotelier, psikologjia e punës, gjellëtari me pastiçeri, organizimi ndërmarrjes hoteliere, kontabilitet, gjeografi turistike, marketing turistik dhe punë në recepsion.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë si në vijim: hyrje në praktikë, mirësjellja dhe higjiena në shërbim, punët ndihmëse në sallonet e shërbimit, mirëmbajtja dhe përdorimi i inventarit për shërbim, shtrimi i tavolinave në restorant, puna në depo, puna në banak, përgatitja e sallës së restorantit për shërbim, pritja dhe vendosja e klientëve, përgatitja e mëngjesit sipas llojeve, përgatitja e salcave bazë, përgatitja e antipastave te ftohta, përgatitja e supave dhe korbave, përgatitja e antipastave te ngrohta, përgatitja e gjellëve prej peshqve, përgatitja e gjellëve prej mishrave-pjekjet, përgatitja e gjellëve vegjetarianë, përgatitja e garniturave, përgatitja e gjellëve prej brumërave desert, kryerja e punëve administrative në recepsion, kryerja e punëve të portierit në recepsion, kryerja e shoqërimit në dhomë, kryerja e punëve të komisionarit në recepsion, menaxhimi i informacionit të brendshëm në hotel, mbajtja e evidencës së klientit, kryerja e rezervimeve në recepsion dhe kryerja e punëve ndihmëse në sektorin e marketingut.

2. HOTELERI, PROFILI: ASISTENT RESTORANTI

Modulet mësimore teorike

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale siç janë: bazat e turizmit, njohje e mallit ushqimor, biologji me higjienë, shërbim hotelier, psikologjia e punës, gjellëtari me pastiçeri, organizimi i punës në gastronomi, kontabilitet, gjeografi turistike dhe marketing turistik.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë si në vijim: hyrje në punën praktike, sjellja dhe higjiena në shërbim, punët ndihmëse në sallonet e shërbimit, mirëmbajtja, përdorimi i inventarit për shërbim, shtrimi i tavolinave në restorant, puna në depo, puna në banak, punët ndihmëse për gatimin e mishit, peshkut në kuzhinë, përgatitja e ofisit për shërbim, përgatitja e sallës së restorantit për shërbim, pritja, pranimi dhe sistemimi i klientëve nëpër tryeza, bonimi-shkruarja dhe pagesa e shërbimeve, mënyrat e shërbimit të ushqimit në restorant, shërbimi i klientëve me pije në restorant, respekton standardet e profesionit, zbaton rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mje-

disit, organizimi dhe shërbimi i çajit të pas drekës dhe shërbimi në kokteje.

3. HOTELERI, PROFILI: GJELLËBËRËS

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: bazat e turizmit, njohje e mallit ushqimor, biologji me higjienë, bazat e shërbimit hotelier, psikologjia e punës, gjellëtari, organizimi i punës në gastronomi, kontabilitet dhe marketing turistik.

Modulet e praktikës profesionale

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit në profilin mësimor "Gjellëbërës", nxënësi do të rrisë në një shkallë më të lartë nivelin e kompetencave profesionale të fituara në shkollë, si dhe do të aftësohet të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë: përgatitja e gatimeve për katering, përgatitja dhe gatimi i ushqimeve për koktej-parti, për bufe të ftohtë, përgatitja dhe gatimi i ushqimeve të ngrohta, përgatitja dhe gatimi i ëmbëlsirave për bufe, gatimi i asortimenteve për bankete dhe pritje solemne, gatimi i asortimenteve me mish të gjedhit, gjahut të egër, shpezëve, gatimi i gjellëve speciale para syve të klientëve, si

flambimi, transhimi dhe filetimi, gatimi i ëmbëlsirave në kuzhinë, përgatitja dhe dekorimi i pjatave për pritje dhe bankete, kryen punë administrative në kuzhinë, llogarit koston e ushqimit në bazë të normativit dhe përdorë në mënyrë të pavarur literaturën me qëllim ngritjen profesionale.

4. HOTELERI, PROFILI: PASTIÇERI

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: bazat e turizmit, njohje e mallit ushqimor, biologji me higjienë, bazat e shërbimit hotelier, psikologjia e punës, pastičeri, organizimi punës në pastičeri, kontabilitet dhe marketing.

Modulet e praktikës profesionale

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit në profilin Pastičeri, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale, si më poshtë: hyrje në punën praktike, sjellja dhe higjiena në shërbim, punët ndihmëse në repartet e pastičerisë, puna në depo, përgatitja e palpetave, e kremrave, e sallatave nga pemët, e petëve, e brumërave, kremrave dhe sulfeve, përgatitja e petullave, kifleve dhe biskotave, përgatitja e reva-

nive, përgatitja e bakllavasë, tullumbave, kadaifit, përgatitja e tortave, kryerja e punëve administrative në pastičeri, përgatitja e prodhimeve me brumë pandispanje, përgatitja e prodhimeve me brumë të shkrifët, përgatitja e prodhimeve me brumë sfoljat, prodhimi i akullores, përgatitja komposto me fruta dhe xhelatinë, përgatitja e tortave special, përgatitja e frutave dhe ëmbëlsirave në flakë dhe përgatitja e minioneve.

5. TREGTI, PROFILI: TREGTAR ME PAKICË DHE SHUMICË

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: kontabilitet, afarizëm komercial, financë, statistikë, bazat e së drejtës dhe e drejta, komunikim biznesi, njohje malli, bazat e transportit dhe bartjes, marketing dhe depo afariste.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë si në vijim: klasifikimi i dokumenteve dhe materialeve, përpilimi i bilancit fillestar të gjendjes, regjistrimet në librin kryesor, kryerja e veprimeve me faturën, komunikimi me mjetet komunikuese, kontratat dhe

korrespondenca e biznesit, veprimet me arkën, hartimi i ofertës dhe i kërkesës, blerja dhe evidentimi i saj, shitja dhe evidentimi i saj, zhvlerësimi i mjeteve jo qarkulluese, qarkullimi i pagesave, veprimtaria e përditshme e një biznesi të vogël, marrëdhëniet e biznesit me bankat, qasja në firmat reale, komunikimi me klientët e bashkëpunëtorët, DUD-I, praktikat e kërkimit të tregut, përgatitja e një reklame të thjeshtë, shërbimi ndaj konsumatorit në njësitë e mëdha të shitjes, vendosja e produkteve në rafte në njësitë e vogla të shitjes, procedurat në transportin rrugor dhe hekurudhor të mallrave, mënyrat e kryerjes së pagesave, skema e financimit të një biznesi dhe qasja në firmat reale.

6. TURIZËM, PROFILI: ASISTENT TURISTIK

Modulet mësimore teorike

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: bazat e turizmit, njohje e mallit ushqimor, biologji me higjienë, bazat e shërbimit hotelier, psikologjia e punës, afarizmi hotelier, organizmi i ndër marrjes hot-turistike, gjeografi turistike, kontabilitet, bazat e statistikës të klientëve dhe marketing turistik.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë, si në vijim: hyrje në punën praktike, sjellja dhe higjiena në shërbim, punët ndihmëse në sallonet e shërbimit, mirëmbajtja dhe përdorimi i inventarit për shërbim, puna në depo, puna në banak, njohja me repartet e kuzhinës, vizitë në monumentet e trashëgimisë kulturore, vizitë në atraksione turistike, vizitë në panairë të ndryshme, punët ndihmëse në hollë të recepcionit, punët ndihmëse në kate të hotelit, punët ndihmëse në depo dhe lavatore, punët ndihmëse në zyre të rezervimit, punët ndihmëse në zyre të marketingut, punët ndihmëse në sektorin e taksi shërbimit dhe kateringut, kryerja e punëve në recepsionin e hotelit, kryerja e punëve të portierit në recepcion, kryerja e punëve komisionarit në recepcion, mbajtja e dokumentacionit të klientëve, përkujdeset për realizimin e kërkesave të klientit, menaxhimi i informacionit të brendshëm në agjencitë turistike, ruan sekretin afarist dhe atë të klientëve, punët ndihmëse në agjencitë turistike për përgatitjen e ofertave dhe mbajtja e pasqyrave dhe evidencave të rezervimeve në agjencitë turistike.





SHKOLLA E MAKINERISË DHE TEKSTILIT “Shtjefën Gjeçovi”

Shkolla profesionale e automekanikës ofron mësim profesional trevjeçar, në tri degët si në vijim: Mekanika, me profilet: automekanik, instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, mekanik i makinave, metalpunues, operator i prodhimit dhe saldator; Tekstil, me profilin konfeksion dhe Transport, si dhe Trafik, me profilin transport rrugor .

Përparësitë e shkollës

Përparësia e kësaj shkolle është se kjo shkollë ka të gjitha kushtet e nevojshme brenda shkollës, ku nxënësit kanë mundësi që edhe modulet e praktikës profesionale t'i kryejnë brenda shkollës. Shkolla është e pajisur me punëtoritë për automekanik, instalues të ngrijës dhe ujit, axhustator, konfeksion, si dhe të gjitha punëtoritë tjera të nevojshme për profilet e shkollës.

Në vitin e parë mësimi zhvillohet katër ditë në javë mësim teorik dhe një ditë mësim praktik, viti i dytë përmban tre ditë e gjysmë mësim teori dhe një ditë e gjysmë mësim praktikë dhe viti i fundit ka tri ditë mësim teorik dhe dy ditë mësim praktik.

1.MAKINERI, PROFILI: AUTOMEKANIK

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson

modulet teorike profesionale, siç janë: vizatim teknik, detalet e makinave, mekanikë teknike, njohuri për automjetet, riparim dhe mirëmbajtje automjetesh, elektroteknika në automjete, elektroteknika në automjete dhe pajisjet për diagnostifikim në automjete.

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë, si në vijim: punime axhusterie, demontimi e montimi i pjesëve të motorit, punime kryesore në sistemin e vajosjes, në sistemin e ftohjes, në sistemin e ushqimit në motor, rregullime në mekanikën e shpërndarjes së gazrave, punime në fraksion, në kutinë e shpejtësisë, në transmetuesin kardanic, në diferencial e gjysmëbosht, në sistemin e drejtimit, në sistemin e frenimit, në sistemin e mbështetjes, në rrota, në sistemin e ushqimit otto motor, në sistemin e ushqimit diezel motor, në burimet e energjisë elektrike, në sistemin e ndezjes, në sistemin e startimit të motorit, në sistemin e ndriçimit – sinjalizimit dhe pajisje ndihmëse, punime diagnostikuese në motor dhe punime diagnostikuese në automjet.

2. MAKINERI, PROFILI: INSTALUES I NGROHJES DHE KLIMATIZIMIT

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: vizatim teknik për instalues të ngrohjes dhe klimatizimit, teknologjia e materialeve, teknologjia e instalimit të ngrohjes dhe klimatizimit, mekanikë teknike, hidraulikë, teknikë ndërtimi, termodinamikë, bazat e elektroteknikës dhe elektronikës, ekonomi dhe organizim dhe vizatim me kompjuter (CAD).

Modulet e praktikës profesionale

Modulet e praktikës profesionale janë, si në vijim: matje dhe kuotime në instalimet e ngrohjes dhe klimatizimit, punime në gypa bakri, instalimi i rrjetit të ngrohjes me gypa bakri në një murmontazhe, instalimi i radiatorëve, punime në gypa çeliku, instalimi i rrjetit të ngrohjes me gypa çeliku në një mur montazhe, punime në mure prej materialeve të ndryshme, instalimi i rrjetit të ngrohjes me kolektorë, përcaktimi dhe eliminimi i parregullsive në sistemet e ngrohjes me radiator, kryerja e punimeve në kaldatore, elektroteknikë dhe elektronikë, instalimi i rrjetit të ngrohjes së dyshemesë, instalimi i ngrohjes diellore, instalimi i sistemit të

klimatizimit dhe ventilimit, përcaktimi dhe eliminimi i defekteve në sistemet e klimatizimit dhe ventilimit, si dhe ngjyrosja dhe termoizolimi në sistemet e klimatizimit.

3. MAKINERI, PROFILI: MEKANIK I MAKINAVE

Lëndët profesionale

Përpos lëndëve të përgjithshme, nxënësi mëson modulet teorike profesionale, siç janë: materialet teknike, vizatim teknik, mekanikë teknike, elektroteknikë dhe elektronikë, hidraulike dhe pneumatike, detalet e makinave, veglat dhe pajisjet, makina metal përpunuese, teknikat e mirëmbajtjes të MMP-së, ecuritë teknologjike të proceseve mekanike, vizatim me kompjuter (CAD) dhe mirëmbajtja dhe diagnostikimi teknik i MMP-së.

Modulet e praktikës profesionale

